

**MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:**

Objekti i kontratës: Dhënie me koncesion te hidrocentralit "Kaçinar"  
 Forma e kontratës: B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)  
 Lloji i kontratës: Pune  
 Vendndodhja e objektit te kontratës: Interesi për shfrytëzimin hidroenergjitik është për pellgun ujëmbledhës të lumit të Shpërdhazës mbi kuotën 168 m. m.n.d.

Kohëzgjatja e kontratës: 35 vjet

**Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 50 date 15.12.2014**

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara:

1. Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive "I-AS" sh.p.k. dhe "Mirdita Konstruksion" sh.p.k.

• Prodhimi i energjise elektrike	16,697,888 kWh	
• Fuqja e vendosur	4,085 kW	
• Koha e zbatimit te punimeve	48 muaj	
• Vlera e investimit (pa TVSH)	315,219,168 Leke	
• Kosto e makinerive dhe pajisjeve për kW fuqi te instaluar (pa TVSH)	42,000 leke/kW	
• Vlera e "Fee koncesionare"	2.1% (350,655 kWh)	
• Vlera ne Para	0.51% (1,607,617 Leke)	

\* \* \*

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron Z. Ndue Shkurti, Përfaqësues i Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive "I-AS" sh.p.k. dhe "Mirdita Konstruksion" sh.p.k., me adrese: Rruga e Kavajës, Pallatet "Lana Park", Njësia Bashkiake nr. 7, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 4 Shkurt 2015, për marrjen me koncesion te hidrocentralit Kaçinar, është pranuar.

Afati i negociimit te Kontratës tuaj do te jete 45 dite nga marrja e njoftimit te fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive "I-AS" sh.p.k. dhe "Mirdita Konstruksion" sh.p.k., kërkohet t'i paraqesë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Përgjithshme dhe te Veçanta te Kontratës Koncesionare/Partneritetin Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës se kërkuar ne Dokumentat Standarte te Procedurës Konkurruese, ne vlerën e 10% te Investimit. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nënshkrimit te Kontratës nga te dy palët.
- Dokument bankar qe vërteton pagesën e kryer e "vlerës ne para" ne përputhje me ofertën tuaj. Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.

- Ne rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet te njoftoni me shkrim brenda 10 (dhjete) ditëve nga marrja dijani.

Afati per dorëzimin e dokumentave te sipërpërmendur do te jete jo me vonë 10 dite nga marrja dijani.

### MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 2.4.2015

Ankesa: Nuk ka